

# **AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "UIK" SH.P.K.**

## **Neni 1**

### **Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesi**

Sot me date 10/12/2019 me cilesine e ortakut themelues si me poshte :

**Z. Zadjona Baykur** ,shtetase Shqiptare, e bija e Flamur Vruzhaj , lindur me dt.31.10.1988 ne Fier , madhor , me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar , identifikuar me karten e identiteti shqiptare me nr.personal : I86031012W.

Bazuar ne Ligjin Nr. 9901 ,dt. 14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare" ,Ligjin Nr. 9723 Dt. 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit" , sot me dt.10/12/2019 ,hartojme kete Akt-Themelimi te shoqerise tregetare si me poshte vijon :

Me neneshkrimin e ketij Akt – Themelimi te shoqerise tregtare ,ne nenshkruetit dhe themeluesit e saj marrim persiper te realizojme e te respektojme te drejtat dhe detyrimet me precizimet e meposhtme:

Te formojme Shoqerine Tregtare me pergjegjesi te kufizuar qe mban emrin "**UIK**" **SH.P.K.**


## **NENI 2**

Shoqeria Tregetare "**UIK**" **SH.P.K.** , ka formen e nje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar.

## **NENI 3**

3.1.Shoqeria e ka seline e saj qendrore ne Fier-Levan,Njesia Administrative Fier, Fshati Levan, Zona kadastrale nr. 2436, nr. pasurie 537/27.

3.2.Ndryshimi i selise qendrore te shoqerise mund te behet vetem me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve te Shoqerise.



#### NENI 4

Kohezgjatja e shoqerise do te jete e papercaktuar.

#### NENI 5

Si rregull aktiviteti i shoqerise mund te zhvillohet ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ,por ai mund te ushtrohet dhe jashte ketij territori ,me hapjen e filialeve apo nepermjet veprimtarive te tjera te karakterit tregëtar.

#### NENI 6

Themeluesit e Shoqerise "**UIK**" **SH.P.K.** me kete akt- themelimi , marrin persiper qe te respektojne te gjitha detyrimet qe parashikon legjislacioni tregëtar e civil shqiptar per shoqerite tregëtare me pergjithesi te kufizuar , si dhe ti permbahet kriterit te respektimit te politikës tregëtare qe zhvillohet sot ne Republikën e Shqipërisë.

#### NENI 7

7.1.Kapitali themeltar i Shoqerise "**UIK**" **SH.P.K.** ne momentin fillestar te krijimit eshte 100,000.00 (Njeqindmije )leke,I cili eshte regjistruar ne llogarine e shoqerise prane nje banke shqiptare te nivelit te dyte , I gjithi I nenshkruar dhe I shlyer prej ortakëve .

Me legalizimin e Shoqerise ne organet kompetente te shtetit Shqiptar dhe me fillimin e ushtrimit te aktivitetit te saj , kapitali Themeltar I kesaj shoqerie mund te zmadhohet .

7.2. Ortaku ka kontribuar dhe zoteron ne kapitalin e shoqerise kuoten me poshte :

**1- Z. Zadjona Baykur**, eshte zoterues i kuotes **100 % te kapitalit themelues** te shoqerise ose I shprehur ne vleren e kapitalit themeltar 100,000.00 leke njeqindmije lekeve .

#### NENI 8

Shoqeria "**UIK**" **SH.P.K.** ashtu sikurse eshte parashikuar ne Aktin Themelimin e Shoqerise ,aktiviteti te saj kryesore do te kete :



"Import,eksport,tregeti me pakice dhe shumice te karburanteve,lendeve djegse ,servis automjetesh ,makineri te ndryshme,tregeti te artikujve te ndryshem,transport karburanti e mallrash,veprimtari ne fushen e ndertimit."

#### NENI 9

##### **Organet drejtuese te shoqerise jane :**

- 1 – Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve perbehet nga :Z/Znj. **Zadjona Baykur .**
- 2 – Administratori eshte :Z/Znj. . **Zadjona Baykur me mandat 5 ( pese) Vjecar, me te drejte riperteritje.**

Detyrat e organeve drejtuese te shoqerise do te percaktohen ne Statutin e shoqerise.

#### NENI 10

Ortaku i vetem themelues i shoqerise ka vendosur qe si **administrator i Shoqerise"UIK" SH.P.K.**do te jete **Z. . Zadjona Baykur.**

Ajo pergjigjet mbi bazen e kompetencave te saja te percaktuara ne Statutine shoqerise.

Gjithashtu ajo do pergjigjet per administrimin e vlerave pasurore te Shoqerise , te cdo natyre qofshin ,te shlyeje detyrimet qe ka Shoqeria me te tretat Brenda vleres se kapitalit ,te beje mbi bazen e kontributeve te dhe ne shperndarjen e fitimit.

Si organ ekzekutiv I Shoqerise ,te drejttat dhe detyrat e administratorit ,rregullohen me aktet themelueset e Shoqerise ,Statutin e Shoqerise si dhe aktet e tjera normative te nxjerra nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve apo dhe me marreveshje te vecanta.

#### NENI 11

Mandati i Administratorit ,per administrimin ne kete shoqeri ,eshte **per nje periudhe 5 vjet me te drejte riperteritje .**

Administratori apo ai qe i delegohet ky pushtet ,ka te gjitha kompetencat te cilat ai deklarohet se i njeh dhe i pranon ,per te kryer te gjitha detyrimet qe i lindin ne baze te statutit te Shoqerise , sikurse parashikohet ne legjidslacionin e Shtetit shqiptar dhe ne menyre te vecante ne "Tre Ligjet per Shoqerite Tregtare ".

#### NENI 12



Ortaku ,administratori dhe punonjesit e **"UIK" SH.P.K.**pergjigjen ndaj shoqerise per demin e shkaktuar nga perhapja e sekreteve tregetare , per te cilat kane dijeni , per shkak te kryerjes se funksioneve te tyre ne shoqeri.

### **NENI 13**

Ortaket themelues **te shoqerise** deklarojne se i njohin te gjitha detyrimet qe rrjedhin nga ky Akt – themelues i Shoqerise **"UIK" SH.P.K.**dhe me vullnet te lire e firmosin ate.

Ky Akt-Themelimi perpilohet ne 4 (kater) kopje origjinale ne gjuhen shqipe , te gjitha me te njejten vlere ligjore.

**PER SHOQERINE "UIK" SH.P.K.  
ORTAKU THEMELUES**

Z. . Zadjona Baykur

